



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE  
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA  
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR**

**VENDIM**

**Nr. 323, datë 14.07.2022**

**PËR**

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT PËR NDRYSHIM  
TË TARIFAVE TË SHOQËRISË UJËSJELLËS KANALIZIME ELBASAN**

Në mbështetje të nenit 13, 14, 21 dhe 22 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "*Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura*", i ndryshuar (*ligji nr. 8102*), dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 539, datë 30.12.2021 "*Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës kanalizime*".

**Komisioni Kombëtar Rregullator,**

në mbledhjen e datës 14.07.2022, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike mbi kërkesën e Ujësjetllës Kanalizime Elbasan sh. a për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime,

**Konstatoi se:**

Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Elbasan është licencuar me vendimin e KKRR nr. 55 datë 28.10.2019 "*Për licencimin e shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Elbasan sh.a*" për shkak të rinovimit të licencës pas përfundimit afatit.

Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Elbasan ka aplikuar pranë ERRU me shkresën nr. 3474 prot, datë 30.06.2022 me lëndë "*Kërkesë për nivel të ri tarifor për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin e ujërave të ndotura*".

Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria UK Elbasan është plotësuar sipas Metodologjisë së Vendosjes së tarifave.

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i shoqërisë UK Elbasan është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në Vendimin nr. 539 datë 30.12.2021 dhe kuadrin rregullator në fuqi,

**VENDOSI:**

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Elbasan për nivel të ri tarife për shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizime.
2. Drejtoria Tekniko Ekonomike detyrohet të njoftojë shoqërinë Ujësjetllës Kanalizime Elbasan dhe Bashkinë Elbasan për vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Ndriçim Shani**